



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

BULETINI

I REFERATEVE TË KANDIDATËVE TË PARAQITUR NË
KONKURSIN Nr. 01-236 TË DATËS 01.08.2016
PËR ZGJEDHJEN E PERSONELIT AKADEMIK

Fakulteti i Edukimit

Programi në gjuhën mësimore Shqipe:

1. Referat për zgjedhjen e një (1) mësimdhënës për lëndët: Gjuhë shqipe I dhe II (programi parashkollor),

Kandidatët:

1. Muharrem Isak Gashi;

2. Referat për zgjedhjen e një (1) mësimdhënës për lëndët: Metodologji e gjuhës shqipe (programi fillor dhe parashkollor), me plotësim orësh në Fakultetin e Filologjisë

Kandidatët:

1. Ragip H. Gjoshi;

3. Referat për zgjedhjen e një (1) mësimdhënës për lëndët: Bazat e arsimit muzikor me metodologji,

Kandidatët:

1. Bajram Çupi;

Programi në gjuhën mësimore Turke:

4. Referat për zgjedhjen e një (1) mësimdhënës për lëndët: Teoria e mësimet, Praktika pedagogjike II dhe III, Bazat e hulumtimit në edukim, Pedagogjia e edukimit parashkollor (programi fillor dhe parashkollor).

Kandidatët:

1. Soner Yildirim;

Programi në gjuhën mësimore Boshnjake:

5. Referat për zgjedhjen e një (1) mësimdhënës për lëndët: Bazat e shkencave natyrore me metodologji, Edukimi mjedisor (programi fillor dhe parashkollor).

Kandidatët:

1. Ajka Aljilji;



RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

Fakulteti: i Edukimit

Lëndët: Gjuhë shqipe I dhe Gjuhë shqipe II (Programi Parashkollor)

Kandidatët e paraqitur:

1. Muharrem Isak Gashi

Shënimet për kandidatin për të cilin shkruhet raporti

Emri dhe mbiemri: Muharrem Gashi

Datëlindja dhe vendlindja: 20. 12. 1959, Atmaxhë, Prizren

Shkollimi superior: Doktor në Shkencat Gjuhësore

Grada shkencore: Doktor

Titujt akademikë: ---

Viti kur është fituar titulli aktual: ---

Departamenti/Fakulteti: ---

Universiteti: ---

Komisioni recensues:

- | | |
|-----------------------------------|---------|
| 1. Prof. asoc. dr. Naser Pajaziti | kryetar |
| 2. Prof. dr. Hasan Muja | anëtar |
| 3. Prof. dr. Sabahajdin Cena | anëtar |

Përmbledhje e aktivitetit shkencor

Kontributi shkencor i kandidatit

Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore

Veprimtaria shkencore e kandidatit	Numri i publikimeve	
	Nga fillimi i karrierës	Në 4 vjetët e fundit
Publikimet shkencore në revistat me "impact faktor" si autor kryesor	0	0
Publikimet shkencore në revistat me "impact faktor" si koautor	0	0
Publikimet në revista të tjera shkencore të publikuara në Kosovë	1	0
Publikimet në revista të tjera shkencore të publikuara në rajon	5	5
(Kontribute të tjera shkencore dhe artistike) Kumtesa me rëndësi shkencore në vend Karakteri Ndërkombëtar	3	2
Trajnime me karakter Ndërkombëtar me Interes në Kosovë Trajnime Ndërkombëtare jashtë Kosovës	4	1
Hulumtimet dhe projektet shkencore		
Takime me rëndësi Ndërkombëtare		
Kumtesat jashtë vendit	2	1

LIBRAT UNIVERSITARE

Nuk ka të dëshmi.

MONOGRAFITË

Nuk ka dëshmi.

Titujt profesional dhe shkencor

Punimet relevante të kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit shënohen publikimet në revistat me "Impact factor")

Tabela 2. Punimet shkencore ose të arritura artistike të kandidatit të cilat tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar

Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Viti / Vëllimi / Numri / Faqet	"Impact factor" (pikët)	Pa "Impact factor"	Nr. i Citimeve
1. Muharrem Gashi, <i>Aspekte të studimeve leksikore në të folmet e Kosovës</i> , "Gjurmime albanologjike", Seria e shkencave filologjike, IAP, Prishtinë, 2010, nr. 39, ff. 187-194.		✓	
2. Muharrem Gashi, <i>Rreth disa aspekteve të përdorimit të formave foljore të mënyrës dëftore në të folmet e Kosovës</i> , "Optime", Albanian University, 2012, nr. 1, Tiranë, ff. 77-84.		✓	

3. Muharrem Gashi, <i>E folmja vendore dhe krahu drejt standardit (Me të dhëna të qytetit të Prizrenit dhe të rrethinës së tij)</i> , "Studime sociolinguistike", 2013, Universiteti i Korçës "Fan S. Noli", Korçë, ff. 282-288.		✓	
4. Muharrem Gashi, <i>Aspekte të emërimit të kafshëve në bazë të ngjyrës, brirëve e shenjave të tjera në arealet e të folmes së Prizrenit dhe rrethinës së tij</i> , "Balkani në mes të Lindjes dhe Perëndimit" (Balkans Between East and West), 2013, Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", Prizren.		✓	
5. Muharrem Gashi, <i>Kundrime dialektologjike mbështetur në të dhëna të qytetit dhe të rrethinave të Prizrenit</i> , "Kërkime gjuhësore", 2014, vëllimi II, QSA, Tiranë, ff. 379-389.		✓	
6. Muharrem Gashi, <i>E folmja e qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij në krahasim me hartat e ADGJSH-së</i> , "Kërkime gjuhësore", 2015, vëllimi III, QSA, Tiranë, ff. 451-463.		✓	
7. Muharrem Gashi, <i>Rreth disa aspekteve të së folmes shqipe të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës me gjuhë të mjedisit në kontakt</i> , "Kërkime gjuhësore", 2016, vëllimi IV, QSA, Tiranë, ff. 417-427.		✓	

Publikime artistike:

1. Muharrem Gashi "Imazhi blu" (përmbledhje poetike), shtypshkronja "Brruti", 1995, Prizren.
2. Muharrem Gashi "Flakë gjaku", KL "F. S. Noli", 1998, Prizren.
3. Muharrem Gashi "Antologji për diellin", KL "F. S. Noli", 2007, Prizren.

Pubikime brenda UPZ: E ka vetëm një punim që është përfshirë në tabelën 2, me numër rendor 4.

Përvoja në mësimdhënie universitare

1. Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, si universitetet ku ka punuar ai, sidhe aktivitetet mësimore dhe profesionale;

Dr. Muharrem Gashi ka dëshmi se në vitin akademik 2012/2013 ka qenë i angazhuar në procesin e mësimdhënies për dy semestra në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti" dhe një semestër në vitin akademik 2015/2016 në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani".

Mobiliteti i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ai ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore)

Nuk ka të dhëna për anagazhime të tilla.

TRAJNIMET NDËRKOMBËTARE JASHTË KOSOVE

Nuk ka të dhëna për trajnime të tilla.

Titulli i cili propozohet: Kandidati dr. Muharrem Gashi nuk propozohet për t'u zgjedhur në thirrjen e mësimdhënësit nga lënda Gjuhë shqipe I dhe Gjuhë shqipe II në Programin Parashkollor.

P ë r f u n d i m

Përfundimi dhe propozimi:

Kandidati dr. Muharrem Gashi nuk i plotëson kushtet për t'u zgjedhur në thirrjen e mësimdhënësit të shpallur me konkurs.

ARSYETIMI:

Në bazë të nenit 173 të Statutit Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" për thirrjen e profesorit asistent kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- 1.1. të ketë gradën e doktorit të shkencës – (E plotëson këtë kriter);
- 1.2. të ketë numër të zgjedhur të monografive dhe publikimeve të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me së paku një punim kryesor të publikuar dhe të shqyrtuar në revista ndërkombëtare si autor i parë ose korrespondent – (Nuk e plotëson këtë kriter);
- 1.5. të ketë së paku tre (3) vjet përvojë pune në procesin mësimor në Universitet – (Nuk e plotëson këtë kriter).

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit recensues:

1. Prof. asoc. dr. Naser Pajaziti (kryetar)

2. Prof. dr. Hasan Muja (anëtar)

3. Prof. dr. Sabahajdin Cena (anëtar)



**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES
PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK**

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	19.09.2016
Zyra e pranimit	Ur. i protokolit
308	02-126

Fakulteti: Fakulteti i Edukimit - Prizren

Lënda/ët: Metodologji e gjuhës shqipe (Programi Parafillor, Programi Fillor në Fakultetin e Edukimit, me plotësim orësh në Fakultetin e Filologjisë)

Kandidatët e paraqitur: 1. Ragip H. GJOSHI

Komisioni recensues:

Prof. dr. Mimoza GJOKUTAJ-ÇANO, kryetar

Prof. dr. Sabahudin CENA, anëtar

Prof. ass. Mazllom KUMNOVA, anëtar

Shënime për kandidatin për të cilin shkruhet raporti:

Emri dhe mbiemri: **Ragip H. GJOSHI**

Datëlindja dhe vendlindja 15. 1. 1957, Sankoc-Drenas

Shkollimi superior: Universiteti i Prishtinës, Prishtinë

Magjistër i shkencave: Universiteti i Prishtinës, Prishtinë

Grada shkencore: Doktor i shkencave të gjuhësisë: Didaktikë e gjuhës shqipe nga viti 2015

Titujt akademikë: Profesor i angazhuar: Ligjërues nga viti 2011/2012 në disa universitete publike dhe kolegje

Viti kur është marrë titulli:

Departamenti/Fakulteti: Universiteti: Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Gjilanit dhe Universiteti i Prizrenit

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor

Kontributi shkencor i kandidatit

Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore

Veprimtaria shkencore e kandidatit	Numri i publikimeve	
	Nga fillimi i karrierës	Në katër vjetët e fundit
Publikimet shkencore në revistat me "impact faktor" si autor kryesor	4	4
Publikimet shkencore në revistat me "impact faktor" si bashkautor		
Publikimet shkencore në revistat pa "impact faktor" si autor kryesor		21
Publikimet shkencore në revistat pa "impact faktor" si bashkautor	5	
Publikimet në revista të tjera shkencore të publikuara në Kosovë		
Publikimet në revista të tjera shkencore të publikuara në rajon		
(Kontribute të tjera shkencore dhe artistike) Kumtesa me rëndësi shkencore të karakterit ndërkombëtar të organizuara në vend		
Trajnime me karakter ndërkombëtar me interes në Kosovë		12
Trajnime ndërkombëtare jashtë Kosovës		
Hulumtime dhe projekte shkencore	13	
Takime me rëndësi ndërkombëtare		
Kumtesat jashtë vendit		8

Libra universitarë

Monografitë

1. GJOSHI, Ragip: *Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë (aspekte historike dhe didaktike)*, Prishtinë, *Armagedoni*, 2015
2. GJOSHI, Ragip: *Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë (aspekte historike dhe didaktike)*, Prishtinë, *Armagedoni*, botimi i dytë, 2016

Libra të tjerë nga i njëjti autor

1. *Dasmë në male: dramë, Rilindja*, Prishtinë, 1985
2. *Fragment nga ditari i maleve: poezi, Rilindja*, Prishtinë, 1996
3. *Kundërshtimi i copëzimit të Kosovës: (publicistikë), Dukagjini*, Pejë, 2010
4. *Udhët e shpirtit: poema, Dukagjini*, Pejë, 2010
5. *Gjaku i bërë dritë: (monografi), Libri Shkollor*, Prishtinë, 2011
6. *Shtegtimet atdhetare të dëshmorit të kombit Mirali Sejdiu, Armagedoni*, Prishtinë, 2015

2. Titujt profesionalë dhe shkencorë

Dr. sc. Ragip Gjoshi në vitin 2015 ka marrë gradën shkencore Doktor i Shkencave të Gjuhësisë në fushën e Metodologjisë së mësimdhënies: Didaktikë të gjuhës shqipe në Fakultetin e Histori-Filologjisë në Universitetin Shtetëror të Tiranës në Tiranë. Po ashtu, ka marrë gradën shkencore Mr. Sc. në Histori në Universitetin Publik të Prishtinës, dhe ka mbaruar edhe një master në ekonomi. Përveç të tjera, ka mbaruar studimet në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Universitetin e Prishtinës (UP), pastaj edhe ato për gazetari .

3. Punime relevante të kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit shënohen publikimet e kandidatit në revistat me "impact factor")

Tabela 2. Punimet shkencore ose të arriturat artistike të kandidatit të cilat tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar

Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Viti / Vëllimi / Numri / Faqet	"Impact factor" (pikët)	Pa "impact factor"	Nr. i citimeve
Gjoshi, R., (2014), <i>Një tekst i rrallë: Abetarja shqipe e vitit 1898</i> , kumtesë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, edicioni i 331, Prishtinë, ISBN 978-9951-00-163-2, ISBN 978-9951-00-165-6	✓		✓
Gjoshi, R., (2014), <i>Vëçoritë fonetike të së folmes së Sankocit (ish- Flamurasit)</i> ,		✓	

Konferenca Ndërkombëtare <i>Java e Shkencës</i> , MASHT, Prishtinë, ISBN 978-9951-16-056-8, ISBN 978-9951-16-057-5			
Gjoshi, R., (2013), <i>Ndihmesa e filologut rumun G. Brankush për gjuhësinë shqiptare</i> , kumtesë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, edicioni i 32\2, Prishtinë, ISBN 978-9951-00-173-1, ISBN 978-9951-00-175-5	✓		
Gjoshi, R., (2014), <i>Gjendja e arsimit shqiptar gjatë Luftës së Parë Botërore</i> , Konferenca Ndërkombëtare <i>Lufta e Parë Botërore dhe Shqiptarët 1914-1918</i> , Fakulteti Filozofik, Prishtinë, ISSN 0351-3750, UDC 082:378, 4		✓	✓
Gjoshi, R., (2014), <i>Shkolla e parë në gjuhën shqipe - Shkolla e Stubllës, Malësia</i> , Mal i Zi, Podgoricë, ISSN 1800-5764, katalogur në: COBISS.CG-ID 3641357			✓
Gjoshi, R., (2014), <i>Menaxhimi i ndryshimeve në arsim në Kosovë</i> , At the Second International Conference of Albania Education, 14-15 November, 2014, Tiranë, Shqipëri		✓	
Gjoshi, R., Kume, K., <i>Reflection on Decentralization Reform of Financial Management in Elementary and Secondary Education In Kosovo</i> , <i>Journal of Educational and Social Research MCSER Publishing</i> , Romë, Itali, ISSN 2239-978X- ISSN 2240-0524-Vol. 4 No.3May 2014273	✓		
Gjoshi, R., https://www.researchgate.net/.../280564351_Journal_Revista_nr7_v2_Ulqin , Jul 30, 2015 - <i>Organizimi i institucioneve arsimore në Kosovë - modeli i menaxhmentit bashkëkohor dhe të ...</i> Ulqin, korrik 2015	✓		
Gjoshi, R., (2014), <i>Misioni dhe vizioni i menaxherit të institucioneve arsimore në Kosovë për shek. XXI</i> . Br/Nr. 6 God - Viti IV/2014, Ulqin, Montenegro - https://www.researchgate.net/.../280564351_Journal_Revista_nr_6_v2....472	✓		
Gjoshi, R., <i>Adapting to the new gymnasium curriculum with teacher training for chemistry and biology subjects 516</i> , <i>2nd Albania International Conference on Education</i> , (AICE), 14-15 November 2014, Tirana, Albania	✓		
Gjoshi, R., <i>Gjuha shqipe në planprogramet shkollore në Kosovë</i> , <i>Seminari i mësuesve të diasporës në Berat</i> , Shqipëri, (2015) www.albaniapress.com/.../ISBN_978-9951-16-091-9		✓	
Gjoshi, R., (2014), <i>Përpjekjet e mësimit të gjuhës shqipe në Kosovë gjatë viteve 1912-1918</i> , <i>Revista Diskutime</i> , f. 193, 2001, Tetovë-Maqedoni www.diskutime.org ISSN, PRINT 1857-825X, ISSN online: 1857- 8543.		✓	✓
Gjoshi, R. (2014), <i>Në gjurmët e traditës së mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë</i> , Prishtinë, 2014. Konferencë Shkencore Ndërkombëtare <i>Java e Shkencës</i> , MASHT		✓	
Gjoshi, R., (2014), <i>Modeli i pritshëm i drejtimit të institucioneve të arsimit në Kosovë për shekullin 21</i> , revista <i>Diskutime</i> , Tetovë, Maqedoni www.diskutime.org ISSN, PRINT 1857-825X, ISSN online: 1857- 8543.		✓	
Gjoshi, R., (2013), <i>Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë nga thellësitë e shekujve deri te Rilindja Kombëtare</i> , në Konferencën Ndërkombëtare <i>Java e Shkencës</i> , II, Prishtinë		✓	✓
Gjoshi, R., (2013), <i>Kundërshtimi i zbatimit të bërthamat e përbashkëta për pavarësimin e shkollës shqipe</i> , Konferenca Ndërkombëtare <i>Java e Shkencës</i> , I, MASHT, Prishtinë		✓	

Gjoshi, R., (2013), <i>Menaxhimi i arsimit të lartë në Kosovë 2005-2010</i> , Konferenca Ndërkombëtare <i>Java e Shkencës</i> , II, MASHT, Prishtinë	✓	
Gjoshi, R., (2014), <i>Menaxhimi i ndryshimeve në arsim në Kosovë</i> , <i>At the Second International Conference of Albania Education</i> , 14-15 November, 2014, Tiranë, Shqipëri	✓	
Gjoshi, R., (2014), <i>Modeli i pritshëm i drejtimit të institucioneve të arsimit në Kosovë për shekullin 21</i> . Revista <i>Diskutime</i> , nr. 12, vëllimi 1, korrik 2014, fq. 243-257: www.diskutime.org ISSN, PRINT 1857-825X, ISSN online: 1857-8543	✓	
Gjoshi, R., (2013), <i>Përpyjekjet që me bërthamat e përbashkëta të dëmtohet lënda e gjuhës dhe letërsisë</i> , Konferencë Ndërkombëtare për Doktorantë në Fakultetin e Filologjisë, Prishtinë	✓	
Gjoshi, R., (2014), <i>Research on the administrator professional training and its role in the implementation of educational institutions reforms in Kosovo</i> . Interdisciplinary Journal of Research and Development <i>Alexander Moisiu University</i> , Durrës, Albania Vol (1), No. 1, 2014	✓	

4. Mobiliteti i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore)

3. Mobiliteti i kandidatit dhe hulumtimi shkencor

Kandidati Ragip Gjoshi studimet themelore i ka përfunduar në vitin 1983 për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Prishtinë, ku kreu edhe studimet në gazetari (komunikim masiv), me notë mesatare 9.1. Ai ka mbaruar edhe studimet pasuniversitare për histori në Prishtinë, me notë 9. Kandidati është studiues i gjuhës, i didaktikës bashkëkohore të gjuhës shqipe, publicist, poet, intelektual dhe, për disa dekada, punëtor i arsimit, pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në mbijetesën dhe pavarësinë e arsimit shqip 1990-1998 si dhe drejtues i arsimit në të gjitha nivelet. Ka punuar gazetar, redaktor e kryeredaktor nëpër shumë gazeta, revista dhe radio. Në periudhën e viteve 1977-1997 ka punuar në arsimin parauniversitar. Nga vitet 1997-1999 ka qenë i angazhuar në luftën çlirimtare, epror i lartë për moral në UÇK. Për një mandat ishte këshilltar i ministrit të Arsimit në Qeverinë e Kosovës, ndërsa pas çlirimit ka kryer punë dhe detyra të ndryshme, kryesisht në arsim, kulturë dhe shkencë. Ishte drejtor departamenti dhe këshilltar i ministrit të MASHT-it në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe ka kryer disa detyra të tjera në drejtimin e institucioneve të arsimit. Kandidati, z. Ragip Gjoshi, ka kryer edhe këto punë dhe detyra:

- Mësimdhënës i gjuhës dhe letërsisë shqipe për 12 vjet;
- Drejtor shkolle 10 vjet;
- Drejtor i Departamentit në KK Drenas, katër vjet;
- Kryetar i Këshillit të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional të Kosovës, tre vjet;
- Kryetar i Bordit të Agjencisë së Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, tre vjet;
- Kryetar i Bordit të Qendrës së Studentëve, tre vjet;
- Anëtar i Bordit për Barazi të Gjuhëve, Kryeministria e Kosovës, katër vjet;

- Përgjegjës i Zyrës për Informim - zëdhënës në Komunën e Drenasit;
- Kryeredaktor i revistës *Spektri*;
- Gazetar i së përditshmes *Dita*;
- Gazetar i së përditshmes *Epoka e re*;
- Gazetar i së përditshmes *Gazeta e re*;
- Gazetar i së përditshmes *Bota sot*;
- Shef për moral në njësitin *Shkaba 5* në Zonën e Drenicës (ZP e UÇK-së);
- Komandant për moral në Brigadën 161 *Ahmet Kaçiku*;
- Shef i Personelit në Zonën e Parë Mbrojtëse të TMK-së;
- Redaktor i revistës *Mbrojtja e Kosovës*, SHP i TMK-së;
- Kryeredaktor i revistës *Mësuesi i Kosovës*, botuar nga MASHT;
- Zëdhënës i Ministrisë së Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, 2011-2014;
- Drejtor ekzekutiv (i përgjithshëm) i Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur të Republikës së Kosovës, si dhe përvojë pune në shumë projekte ndërminstrore në kuadër të Qeverisë së Kosovës.

Përveç punës së frytshme pedagogjike dhe kërkimore-shkencore, kandidati Ragip Gjoshi ka dhënë kontribut dhe ndihmesë në organizimin dhe mbarëvajtjen e punës së arsimit në Kosovë në të gjitha nivelet përgjatë vitit 1975-2016, përveç në arsimin parauniversitar, edhe në arsimin e lartë. Ai është shquar sidomos në punën e mbijetesës së shkollës shqipe gjatë viteve 1990-1999.

Po sjellim disa nga aktivitetet në mësimdhënie në arsimin e lartë te aplikantit.

Kandidati dr. sc. Ragip Gjoshi ka disa vite përvojë pune si mësimdhënës (ligjërues) i angazhuar në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë, në vitet 2012-2014, në lëndët:

- Metodologji e gjuhës shqipe;
- Menaxhim dhe udhëheqje në arsim; dhe
- Shkrim akademik

Aplikanti ka punuar edhe në Fakultetin e Edukimit "Kadri Zeka" në Gjiilan (2014-2015). Ka ligjëruar lëndën:

- Metodologji e gjuhës shqipe.

Kandidati ka punuar edhe në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren në vitin 2016, në lëndët:

- Metodologji e gjuhës shqipe;
- Morfologji historike e gjuhës shqipe; dhe
- Stilistikë e gjuhës shqipe.

Nga viti 2011/2016 punon në BPrAL "BIZNESI" në Prishtinë, mësimdhënës-ligjërues i lëndëve:

- Shkrim akademik dhe kulturë gjuhe;
- Shkathtësitë e mësimit akademik.

Nga viti akademik 2015 punon edhe në BPrAL AAB në Prishtinë, mësimdhënës-ligjërues i lëndëve:

- Morfologji e gjuhës shqipe;
- Sintaksë e gjuhës shqipe.

Aplikanti ka përvujtë të gjatë prej disa dekadash në mësimdhënien e gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar. Ai ka disa vite përvujtë pune si drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët "Luigj Gurakuqi" në Sankoc të Drenasit.

Trajnimet ndërkombëtare jashtë Kosovës

1. Seminari i mësuesve të diasporës në Berat, Shqipëri. *Gjuha shqipe në planprogramet shkollore në Kosovë*, Berat, Shqipëri, 2015;
2. Vlerësimi dhe monitorimi i programeve - mbikëqyrje, monitorim dhe vlerësim, Ohër 2012;
3. Konferenca shkencore *102 vjet shtet shqiptar dhe më pas*, nëntor 2014, Tetovë-Maqedoni;
4. Programi i trajnimit dhe certifikimit në metodika e praktikës profesionale, USAID, 2011 Prishtinë;
5. Certifikatë për pjesëmarrje në seminarin ndërkombëtar *Zhvillimi i programeve studimore sipas parimeve të procesit të Bolonjës*, nëntor 2012, organizuar nga IPAL-AAB, Prishtinë;
6. Certifikatë nga konferenca shkencore *Çështja shqiptare dhe Drrallajt*, 6-7 dhjetor 2014, Tetovë-Maqedoni;
7. Certifikatë TOEIC, The Test of English for International Communication (TOEIC) is an English language test designed specifically to measure the everyday English skills of people..., Tiranë, 2014;
8. Certifikatë: Ecim tutje, arsimimi për zhvillim ekonomik - cdbe (Education-Economics-Conference-Documentation), Prishtinë, 2013;
9. Certifikatë 2nd Albania International Conference on Education (AICE), 14-15 November 2014, Tirana, Albania;
10. Certifikatë: Konferencë ndërkombëtare *Demokracia në Evropën Juglindore*, 9 maj 2015, Tetovë, Maqedoni;
11. International Conference-First World War And Albanians (1914-1918), 28 jun 2014, The University of Prishtina "Hasan Prishtina", Prishtinë;
12. The second edition of the International Congress on Vocational and Professional Education and Training took place from June 20-22 2016, Winterthur, Switzerland;
13. The 8 th International Conference, The role and effectiveness of investments in the integration process of the Balkan societies after Stabilisation Association, Ulcinj - Montenegro, 1. 4. 2016;

14. The V-th international scientific Conference *Investment in The function of economic Development and integration process*, Ulqin-Ulcinj, Montenegro, 5. 4. 2013.

Kandidati doktoroi në korrik të vitit 2015 në studime gjuhësore - Didaktikë të gjuhës shqipe në Universitetin e Tiranës (Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë) në Tiranë - Shqipëri në temën *Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë (Nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)*. (Doktor i shkencave të gjuhësisë: Metodologji dhe didaktikë e gjuhës, nr. 1145). Diplomën e ka të barasvlerësuar (nostrifikuar) nga MASHT-i me nr. 6-3945. Kandidati ka mbaruar edhe studimet në master për ekonomi dhe është edhe doktor i ekonomisë - Administrim Publik, Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Shqipëri, në temën *Modeli i menaxherit të institucioneve të arsimit për shek. XXI në Republikën e Kosovës (Menaxhimi dhe udhëheqja arsimore në dritën e reformës në Kosovë)*.

Kandidati, përveç angazhimit të tij në mësimdhënie universitare dhe parauniversitare me 40 vjet përvojë, ai ka dëshmuar se është specialist i fushës që nga formimi i tij profesional i shkollimit të mesëm (ka të mbaruar Shkollën e Mesme Normale (shkollë pedagogjike pesëvjeçare). Ai ka qenë i orientuar në fushën e mësimdhënies, ku ishte mjaft aktiv, si dhe në publikimin e rezultateve kërkimore-shkencore nëpër revista pedagogjike, si dhe në pjesëmarrje në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Kandidati ka një formim profesional shumëplanësh, si filolog, metodist i gjuhës shqipe, gazetar dhe specialist i menaxhimit të arsimit. Në të gjitha fushat e diplomuara, në studimet finale të temave të diplomës, kandidati i ka të trajtuar ekskluzivisht fushën e mësimdhënies, udhëheqjes dhe menaxhimit në arsim dhe përgjithësisht didaktikën e gjuhës shqipe dhe zhvillim të arsimit dhe edukimit. Komisioni recensues gjatë seancave të veta trajtoi aplikacionin e kandidatit dr. sc. Ragip Gjoshi shqyrtoi materialin e ofruar dhe

Konstatoi,

se kandidati Ragip Gjoshi, i lindur më 15 janar 1957 në Sankoc të Drenasit, i doktoruar më 2 korrik 2015 në shkencat e filologjisë (me specializim në Metodologjinë e mësimdhënies: Didaktikë të gjuhës shqipe) në Fakultetin e Histori-Filologjisë të Universitetit të Tiranës në Republikën e Shqipërisë, i plotëson kushtet për t'u zgjedhur mësimdhënës për lëndën *Metodologji e gjuhës shqipe (Programi fillor dhe Programi parafillor në Fakultetin e Edukimit)*, me plotësim orësh në *Fakultetin e Filologjisë*, në frymën e dispozitave të Statutit të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", prandaj edhe propozohet të zgjidhet. Propozimi bëhet në frymën e akteve normative të këtij organi dhe në frymën e konkursit të 2 gushtit të këtij viti.

Kandidati i propozuar, Ragip Gjoshi, ka dëshmuar profesionalizëm në fushën specifike të kërkuar në konkurs, si dhe një përkushtim, pjekuri dhe rezultate të rëndësishme. Kandidati dëshmon se ka qenë mësimdhënës, drejtues i arsimit, redaktor, recensues i disa monografive dhe revistave pedagogjike e shkencore.

Mbështetur në të dhënat burimore nga dosja e kandidatit dhe në pajtim me kriteret normative të parapara nga Universiteti, kandidati dr. sc. Ragip Gjoshi vlerësojmë se i

plotëson kushtet e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, konform nenit 173, i cili rregullon kushtet për zgjedhjen e profesorit asistent, kriterëve të konkursit të shpallur nga Senati i UPZ (Nr. ref. 01/236, dt. 1 gusht 2016) dhe dispozitave të Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë, për t'u propozuar për **PROFESOR ASISTENT**.

Komisioni recensues bën këtë:

PROPOZIM

Në bazë të asaj që u tha deri më tani, në pajtim me dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe në kriteret e konkursit të shpallur për personelin akademik, kemi nderin dhe kënaqësinë që Këshillit Mësimor të Fakultetit të Edukimit dhe Senatit të këtij Universiteti t'i propozojmë që kandidatin **dr. sc. Ragip Gjoshi** ta zgjedhë mësimdhënës në Fakultetin e Edukimit në titullin **profesor asistent** (prof. ass. dr) për lëndën **Metodologji e gjuhës shqipe** (Programi Parafillor dhe Programi Fillor në Fakultetin e Edukimit, me plotësim orësh në Fakultetin e Filologjisë).

4. Titulli akademik që propozohet

Titulli **profesor asistent**(prof. ass. dr.) propozohet sepse:


1. Dr. sc. Ragip Gjoshi gjatë punës së tij shumëvjeçare në mësimdhënie dhe përgjithësisht në arsim dhe edukim, si dhe në punën kërkimore shkencore ka dëshmuar përkushtim profesional dhe formësim të avancuar pedagogjik e metodik, si fushë e tij e specializimit.
2. Dr. sc. Ragip Gjoshi është një intelektual shumë aktiv në jetën akademike, në veçanti në pjesëmarrje në konferenca shkencore, në botime dhe në punë kërkimore-shkencore.
3. Dr. sc. Ragip Gjoshi është i specializuar në metodologjinë e mësimdhënies së gjuhës shqipe. Deri më tani ka botuar dhjetëra punime shkencore në fushën e mësimdhënies dhe monografinë gjithëpërfshirëse të didaktikës së gjuhës shqipe *Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë (aspekte historike e didaktike)*. Kështu që, kandidati ka dëshmuar një përkushtim sistematik të avancimit profesional dhe akademik.

Komisioni recensues:

Prof. dr. Mimoza GJOKUTAJ-ÇANO, kryetar

Prof. dr. Sabahudin CENA, anëtar

Prof. ass. Mazllom KUMNOVA, anëtar



Prizren, më 13 shtator 2016



RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

Fakulteti: I Edukimit

Lënda/ët: Bazat e arsimit muzikor me metodologji

Kandidatët e paraqitur: **Bajram Çupi**

Shënimet për kandidatin për të cilin shkruhet raporti

Emri dhe mbiemri: Bajram Çupi

Datëlindja dhe vendlindja: 05.10.1967, Kërçovë

Grada shkencore: Dr. i Artit muzikor

Titujt akademikë: Prof. i asoc. (Prof. inord.)

Viti kur është fituar titulli aktual: 2013

Departamenti/Fakulteti: Fakulteti i Arteve – Dega e Artit muzikor

Universiteti: Universiteti Shtetëror në Tetovë

Komisioni recensues:

- | | |
|-------------------------------|---------|
| 1.Akademik. Mr. Rauf Dhomi | kryetar |
| 2.Prof. Dr. Arifikmet Xhemali | anëtar |
| 3.Prof. Dr. Isak Shehu | anëtar |

Titulli akademik për të cilin shkruhet raporti:

Ass, **Prof. Ass**, Prof. Asoc, Prof. i rregullt...

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor

Kontributi shkencor i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen publikimet më të rëndësishme duke u bazuar në CV e kandidatit)

